




## Lexues Karte PIN i Sigurtë



eALEAT Lexues Karte PIN i Sigurtë është një Lexues Karte me USB "lehtësisht i instalueshëm dhe i përdorshëm". eALEAT është Platforma elektronike e Aleat Sh.p.k., kompania e cila prodhon Kartat e Identitetit Shqiptarë dhe Pasaportat Biometrike, në emër të Ministrisë së Punëve të Brendshme në Shqipëri, tani ofron autentikim elektronik dhe shërbime të besuara me përdorimin e Kartave të Identitetit.

Lexues Karte PIN i Sigurtë ofron PIN të sigurtë për të gjitha transaksionet e autentikimit dhe nënshkrimin dixhital dhe gjithashtu ka karakteristika të tjera të tilla si funksionin e një makine llogaritëse dhe eKuleta /Kuleta elektronike. PIN i Sigurtë do të thotë se kodi PIN nuk transmetohet në kompjuter, është i koduar në pajisje.

Platforma eALEAT ofron tre shërbime kryesore dhe Lexuesi i Kartës PIN i Sigurtë plotëson të gjitha shërbimet si në vijim:

| eALEAT Shërbimet |   | Përkrahimi i Shërbimit   | Lexuesi i Kartës PIN i Sigurtë |
|------------------|---|--|--------------------------------|
| 1.               | Autentikim             | Vërteton mbajtësin (të zotin) e kartës ID me vetë Kartën ID (njëhësim me kartën) përmes hyrjes me kodin PIN.   | ✓                              |
| 2.               | Autentikim & të dhëna  | Vërteton dhe siguron të njëjtat të dhëna të mbajtësit të Kartës ID sikurse në letërnjoftim, në mënyrë elektronike, me autorizim nga mbajtësi i Kartës (pronari) nëpërmjet hyrjes me Kodin PIN. | ✓                              |
| 3.               | Nënshkrim Elektronik   | Mbajtësi i Kartës ID mund të nënshkruajë në mënyrë elektronike dokumente elektronike dhe nënshkrimi elektronik është ligjërisht i drejtë dhe i pranuar me legjislacionin Shqiptar në fuqi.     | ✓                              |

### Pajtueshmëria e Sistemit me Shërbimet eALEAT:

Aktualisht Shërbimet eALEAT punojnë me Sistemet Operative Windows XP dhe Windows 7 dhe shfletuesit e listuar (Internet Explorer, Mozilla Firefox dhe Google Chrome). Ju lutem konsultoni faqen e internetit Aleat [www.aleat.al](http://www.aleat.al) Seksionin Lexues Karte për më shumë informacion mbi të rejat aktuale.

### Si funksionon?

eALEAT Lexues Karte PIN i Sigurtë është i lehtë për t'u instaluar në çdo PC ose Laptop. Nuk ka nevojë për driver shtesë, thjesht lidhni USB-n në PC / laptop dhe ajo do të jetë në gjendje për të punuar me Platformën eALEAT. Testo lexuesin tuaj të Kartës dhe Shërbimet eALEAT në [www.aleat.al](http://www.aleat.al) seksionin Lexues Karte. Ky Lexues Karte lexon çip-in e Kartës Smart të Letërnjoftimit Shqiptar. Ju lutem referojuni fotove të treguara më poshtë për të parë se çfarë ane vendoset karta ID/Letërnjoftimi.



Vendosja e USB-së së Lexuesit

Shkëput USB nga Lexuesi



Vendos Kartën ID tek Lexuesi i Kartës

### Të dhëna Teknike:

|                       | SPECIFIKIME                          | NËRDERFAQJA E SISTEMIT DHE KARTES SMART |  |
|-----------------------|--------------------------------------|---|--|
| Numri modelit         | APG8201 PinHandy1                    | Shpejtësia e Transmetimit               | USB 2.0 (shpejtësi e plotë)  |
| Ngjyra                | I Bardhë me Kapak Blu                | Standardet                              | 12 Mbps  |
| Tastiera              | 20 butona silikonike gome            | Kartat e përdorshme                     | ISO 7816 Klasi A (5 V), T=0 dhe T=1  |
| Ekrani LCD            | Ekrani Grafik LCD                    | Njohja e Smart Kartë-s                  | Karta me Mikroprocesor të Madhësisë së Plotë, ISO 7816 Klasi A   |
| Përmasat              | 95 x 60 x 11 mm                      |   | Zbulimi automatik i tipit smart kartë  |
| Pesha                 | 49 g                                 | Mbrojtja Qark i Shkurtër                | +5 V/GND në të gjitha PIN-et   |
| Furnizimi me energji  | Portë USB-je                         | PC / SC Driver                          | Windows XP / Vista / 7 / 8   |
| Gjatësia Kabullit     | 150 cm, i shkëputur, USB B           |   | Server 2003, 2008, 2008 R2, 2012   |
| Bateri                | 2x bateri CR2032 (të zëvendësueshme) |   | Linux, Mac @ OS X (Intel),   |
| Qëndrueshmëria        | 100,000 vendosje karte               |   | Android 3.1 dhe më sipër   |
| Tipare të tjera       | Makinë Llogaritëse, eKuleta          | Pajtueshmëria / Certifikimi             | MasterCard CAP, MasterCard AA4C/PLA, Visa DPA, EMV Niveli 1, CE, FCC, CCID, RoHS, ISO 7816, PC/SC 2.01 |
| Temperatura Operative | 0-50 °C                              |   |  |
| Lagështia Operative   | 10-90% rH                            |   |  |

### Garancia:

Aleat Sh.p.k. jep garanci 6 muaj nga data e blerjes, sipas faturës së blerjes.